REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZE

KESHILLI BASHKIAK

*Adresa: Lagja "Minatori"* *email: bashkiabulqize@hotmail.com*

# VENDIM

**NR 20 DATE 28 / 2 /2018**

**Per**

"Miratimin e kerkeses se Bashkise Bulqize,se bashku me dokumentacionin ligjor per akordimin e ndihmes financiare per rehabilitim te perroit te Lagjes "Allmete",ne Lagjen "Gjeologu"Qytetit te Vjeter Bulqize, i cili eshte demtuar nga reshjete rena ne periudhen Nentor-Dhjetor 2017 nga buxheti i Bashkise dhe buxheti i vitit 2018 ne Ministrine e Punevete Brendshme,programi "Emergjencat Civile".

**BAZA LIGJORE :**

Ligji 139/2015 "Per VeteqeverisjenVendore",Ligji Nr.107,date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut", Ligjit Nr 8756,date 26.03.2001 "Per EmergjencatCivile",i ndryshuar,VKM Nr. 329,date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera teshkaktuara nga veprimtaria njerezore", **Keshilli Bashkiak ne mledhjen e tij te dates 28.02.2018 pasi diskutoi rreth projketit te paraqitur nga Drejtoria e Sherbimeve.Emergjencave Civile dhe Rrugeve Ruralle,me 15vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim**

**VENDOSI:**

1.Te miratoje kerkesen e Bashkise Bulqize per mbeshtetje financiare per rehabilitim te perroit "Allmete",te Lagjes "Gjeologu"te Qytetitte Vjeter Bulqize per demtimin e tij nga reshjet e rena.

2.Te miratoje dokumentacionin tekniko-ligjor te hartuar nga Bashkia Bulqize,dhe vleren e demit te shkaktuar : 53.724 (pesedhjete e tre mije e shtateqind e njezet e kater)leke deme.

3.Ti paraqese dokumentacionin perkates dhe ti kerkoje mbeshtetje Drejtorise se Pergjitheshme te Emergjencave Civile prane Ministrise se Puneve te Brendeshme per ndihme financiare, per shkak te pamundesise se Bashkise per te mbulua rvleren financiare te riparimit te demit te shkaktuar.

4.Ndihmaf inanciare qe do te akordohet do te perdoret per rehabilitimin e perroit "Allmete" ne Lagjen "Gjeologu" ne Qytetitte Vjeter.

**Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.**

**PER KESHILLIN BASHKIAK**

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Agim TUCI** **Gazmend KENGA**

Dixhitalizuar ne kuader te projektit STAR i permes Qendres per Çështjet e Informimit Publik
www.infocip.org
www.vendime.al